



RELACION TEKNIK

MANASTIRI I "SHËN MËRISË" ARDENICË

TIRANË 2021



GRUPI I PROJEKTIMIT

ARK. RONELA ÇUKU

ARK. ARBJONA BALA

ING. ZAIM LILA

Ronela

cuku

Arbjona

Bala

Digitally signed by
Ronela cuku
Date: 2021.06.29
11:47:53 +02'00'
Digitally signed by
Arbjona Bala
Date: 2021.06.30
11:10:59 +02'00'

MIRATOHET
SEKRETARI I KTKM-së
ARTA DOLLANI



Tabela e Përmbajtjes

1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME, VENDNDODHJA DHE ARRITSHMËRIA.....	2
2. PËRSHKRIMI ARKITEKTONIK	3
2.1 Konakët	5
2.2 Kishat	7
Kisha e Shën Thanasit	7
Kisha “Fjetja e Shën Mërisë”	7
2.3 Sistemi i furnizimit me ujë.....	9
3. FAZAT E NDËRTIMIT TË KONAKËVE.....	9
3.1 Fazat e ndërtimit të kapelës së Shën Triadhës.....	11
3.2 Faza e ndërtimit të kishës “Fjetja e Shën Mërisë”.	12
3.3 Datimi.....	13
3.4 Teknikat e ndërtimit.	14
4. RESTAURIMET DHE SONDAZHET NDËRVITE	15
4.1 Nërhyrjet në konakë	15
4.2 Ndërhyrjet në kishat.	16
5. GJENDJA EKZISTUESE E MONUMENTIT DHE NDËRHYRJET RESTAURUESE QË PROPOZOHEN.....	17
5.1 Të përgjithëshme	17
5.2 Kishat	18
Kisha e Shën Thanasit	18
Kisha “Fjetja e Shën Mërisë”	19
5.3 Sistemi i furnizimit me ujë.....	23
5.4 Konakët	24
6. BIBLIOGRAFIA	



1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME, VENDNDODHJA DHE ARRITSHMËRIA





Fig. 1 – Pamje ajrore e Manastirit; Lidhja e Manastirit me fshatin e Kolonjës.

.....

ZONA E MBROJTUR "KISHA E MANASTIRIT TË SHËN MËRISË-ARDENICË", KOLONJË, LUSHNJË



LEGJENDA: Manastiri Perimetri i zonës së mbrojtur

Koordinatat e sipërfaqes së zonës së mbrojtur të monumentit:

1. 40°46'8.48"N	19°35'22.37"E	6. 40°46'9.51"N	19°35'35.27"E	11. 40°46'4.57"N	19°35'37.67"E
2. 40°46'16.42"N	19°35'25.00"E	7. 40°46'2.14"N	19°35'2.48"E	12. 40°46'6.87"N	19°35'29.61"E
3. 40°46'18.17"N	19°35'33.90"E	8. 40°46'0.47"N	19°35'1.17"E		
4. 40°46'19.40"N	19°35'42.70"E	9. 40°45'59.70"N	19°35'46.67"E		
5. 40°46'26.39"N	19°35'47.30"E	10. 40°46'1.30"N	19°35'51.62"E		

Fig. 2 – Pamje ajrore e Manastirit; Zona e mbrojtur e manastirit.

Fig. 3 – Pamje ajrore e Manastirit



Manastiri i Ardenicës ndoshtet në lartësinë 237 m mbi nivelin e detit, në kodrën e fshatit Kolonjë të rrethit të Lushnjës, mes një pylli me pisha dhe selvi. Kodra është pjesë e një vargu kodrinor që e përshkron fushën e myzeqesë nga veriu në jug, në një pozicion shumë piktoresk: nga njëra anë hapët një pamje e gjerë e fushës dhe e malit të Tomorrit, ndërsa nga ana tjetër veshtrimi shtrihet deri në Detin Adriatik. Sipërfaqja e Manastirit, brenda mureve, është rreth 2500 m². Manastiri është shpallur monument kulture i kategorise së I nga:

1. Instituti i Shkencave me vendim Nr.586, datë.17.03.1948;
- 2.Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës me vendim Nr.6, datë.15.01.1963;
- 3.Ministria e Arsimit dhe Kulturës me vendim Nr.68/7 datë.30.05.1970;
- 4.Ministria e Arsimit dhe Kulturës me vendim Nr.1886 datë.10.06.1973.

Fshati më i afërt me manastirin është fshati Kolonjë i bashkisë së Lushnjës, me të cilin manastiri lidhet nëpërmjet një rruge automobilistike rreth 2.17 km e gjatë (Fig.1). Kjo rrugë është e nivelit dytësor; rrugë me dy kalime me nga një kors, e asfaltuar dhe në gjendje të mire. Fshati ndodhet rreth 1.5 km largë rrugës nacionale, Autostradën Lushnjë - Fier.

2. PËRSHKRIMI ARKITEKTONIK

Manastiri i Ardenicës bën pjesë në tipin e manastireve ortodokse ku veçori kryesore është zhvillimi i planimetrisë me fokus qendror kishën. Kompleksi që përfshin majën më të lartë i shfrytëzon mjaft mirë mundësitë që i ofron terreni. Ky i fundit ka kushtëzuar edhe formën planimetrike të konakëve, konturi i të cilëve formon një trekëndësh jo të rregullt.




Fig. 4 – Gen-plani i Manastirit

Thuajse në qendër të manastirit ndodhet kisha Fjetja e Shën Mërisë, ndërsa në qoshen veri lindore të saj, ngjitur me konakët e kësaj ane, qëndron kapela e Shën Triadhës. Vargu i konakëve, në pjesën më të madhe, është dy katësh. Në të përfshihen dhomat e fjetjes, dhoma



për miqtë, mjediset e depove dhe qilarëve, furra, stallat, mulliri për nxjerrjen e vajit dhe dhoma e rojes së portës. Uji sigurohej me anë të sterave. Pjesa e lirë organizohej në katër oborre, prej tyre oborri perëndimor zhvillohet në dy nivele, një pjesë e zë platforma, në kuotë të njëjtë me hajatin e kishës.

Forma e terrenit bënë që ndërtimet të realizohen në disa nivele. Pjesën më të lartë e zë kapela e Shën Triadhës, pastaj vjen kisha e madhe, ndërsa kuotën më të ulët e zë qoshja perëndimore e konakëve.






Fig. 5 – Planimetrit e Manastirit







SKEMA FUNKSIONALE E MANASTIRIT
TE ARDENICES



KATI PERDHE



SKEMA FUNKSIONALE E MANASTIRIT
BIZANTIN



KATI I PARE

shpjegues

[Cross-hatched pattern]	UJRIET	[Diagonal lines]	DHOMA E FETJEJE
[Cross-hatched pattern]	DHOMA E PORTARIT	[Solid black]	CEPO UJRI
[Cross-hatched pattern]	DHOMA	[Diagonal lines]	KORIDOR, HALL ET
[Cross-hatched pattern]	GRUPIMET	[Diagonal lines]	ENDENTE FETJEJE
[Cross-hatched pattern]	TERRAZET	[Diagonal lines]	BIBLIOTEKA
[Cross-hatched pattern]	AMBULANTE NGJEVE	[Diagonal lines]	MUR TË HUES

Fig. 6 – Skema funksionale e manastirit krahasuar me skemën e një manastiri bizantin

2.1 Konakët

Konakët që zënë pjesën më të madhe të kompleksit, përfaqësojnë pjesën e tij periferike. Fasadat nga oborri përshkrohen nga një korridor i hapur, i cili realizon komunikimin e mjediseve të vendosura njëri pas tjetrit.



Hyrja kryesore zhvillohet në formën e një galerie të mbuluar me një qemer cilindrik, me seksionin më të shtrirë se gjysma e rrethit. Hyrja tjetër, për bagëtitë, ndodhet në anën veriore. Blloku i hyrjes përbën pjesën më të trajtuar, jo vetëm nga ana formale, por edhe funksionale. Ai përkon me rrugën që të sjell në manastir nga fshati i Kolonjës duke bërë kështu edhe paraqitjen e parë me vizitorin. Rruga nga parkimi aktual deri në hyrjen e manastirit është e shtruar me kalldrëm i cili ndërpritet vetëm nga porta e hyrjes mbuluar me hark guri. Në korridorin e parahyrjes së portës gjenden sofatë për ndënjie. Pas portës, në krahun e djathtë, ndodhet mjedisi i mullirit të vajit, i mbuluar me qemer cilindrik me dormues very-jug. Qemeri është i ndërtuar me tulla dhe përforcohet nga dy harqe-nervatura. Ndricimi i këtij ambjentit bëhet nëpërmjet tre dritareve në faqen lindore. Në anën e majtë të portës hyrëse ndodhet dhoma e rojes së portës, e mbuluar me qemer cilindrik ndërtuar me të njëjtën teknikë si ajo e ambjentit të mullirit. Mjediset që ndodhen mbi këtë bllok kanë qenë më të zgjedhurat, ndër to dallon pjesa qendrore, mbi hyrje, e cila shërben si dhomë pritje. Fasadat e këtij ambjenti janë të suvatuara dhe të lyëra më shërbet gëlqere. Suvatimi i fasadës shkon dëri në mes të strehës me një profil të kurbëzuar, veçori që haset edhe në banesat qytetare. Në ball ky amjent del me dy dritare në qendër të së cilave ndodhet një derë druri që të nxjerr në ballkonin e ndërtuar me strukturë druri. Dhoma e pritjes ndriçohet edhe nga dy dritare të tjera në nivel më të ulët, në faqet anësore. Në veri të dhomës së pritjes ndodhen dy dhoma të pozicionuara mbi mullirin e vajit. Hyrja e tyre është e drejtëpërdrejtë dhe kanë të përbashkët platformën e një shkalle të vogël. Më tutje në drejtim nga veriu, ndërtimi është i një faze më të vonëshme. Dhomat në këtë pjesë deri në qoshen veriore, kanë qenë përdorur si klasa shkolle në periudhën e fundit të përdorimit të manastirit, ndërsa kati përdhe i tyre ka shërbyer si katua apo vend për mbajtjen e bagëtive. Ndarja e parë e katoit komunikon në krahun përendimor me një dhomë të mbuluar me qemer guri, e cila ka funksionuar në vitet e komunizmit si vend për të sëmuret psikik. Në këtë mjedis mund të hyhet nga oborri nëpërmjet një shkalle guri. Në qoshen veri lindore të konakëve ndodhet një hajat i cili kufizohet prej dhomave dhe sterës ngjitur me kapelën e Shën Triadhes.

Vargu i krahut verior përbëhet nga dhoma të lidhura nga një korridor gjatësor, hyrja e të cilit del në oborrin verior. Ky krah vazhdonte deri në drejtim të murit perëndimor të nartëksit të kishës. Sot një pjesë e tij është rrënojë. Thuhet se plotë ruhet vetëm fasada jugore, ku dallohen dritaret dhe porta me hark. Faqja veriore, ruhet vetëm në lartësinë e katit përdhe ku ndodheshin stallat.

Më tej linja thyhet, dhe dhomat që pasojnë në drejtimin perëndimor spostohen për nga jashtë. Dy mjediset e para të këtij segmenti janë përdorur si furrë pjekie. Mjedise të tjera ndihmëse ka patur edhe në anën e jashtme. Fasada nga oborri i këtij ambjenti ka qenë me arkadë guri, prej së cilës ruhen vetëm dy harqe. Në faqen e jashtme të pilastrit, ndodhet një pllakë guri me mbishkrimin në gjuhën greke, e cila mban datën 1770. Nga gjurmet e sotme nuk është e mundur të kuptojmë nëse kjo pjesë ka qenë dy katëshe apo jo. Gjurmët më të vjetra të ndërtimit në vazhdim janë të pa diskutueshme, pasi deri në qoshen perëndimore, një rindërtim dy katësh, i mëvonshëm ka zhdukur mjaftë nga gjurmët e para.

Dhomat e mësipërme komunikojnë me krahun jug perëndimor nëpërmjet korridorit të hapur si në katin përdhe ashtu edhe në atë të sipërm. Ndërsa kati përdhe i krahut jug perëndimor ruan formën origjinale të arkadës, pjesa tjetër është rindërtuar me kolona guri, mbi të cilat mbështetet struktura e sipërme prej druri. Korridori i sipërm i krahut jug perëndimor



komunikon me oborrin nëpërmjet një shkalle dyrambëshe prej guri të realizuar më dy qemerë lehtësues. Ashtu sikurse në mjediset e hyrjes edhe në dhomat e kësaj pjese, dyert janë të mbuluara me hark guri të përvizuar nga sipër me një shirit tullash. Në drejtim të hyrjes, godina ndërpritet. I tërë segmenti jug perëndimor i dhomave në anën e jashtme të tij është i përforcuar nga një sër kontrafortësh, kjo si rezultat i terrenit të thyer.

2.2 Kishat

Kisha e Shën Thanasit është një kapelë me përmasa 7.5x3.7m., së cilës nga ana lindore i bashkëngjitet një sterë. Hyrja për në kishë ndodhet në anën perëndimore. Ambjenti ndricohet nga dy dritare të vogla, në faqen jugore. Nga ana veriore kapelës i mbështeten dhomat e manastirit, duke lënë në këtë mënyrë të dukshme vëtëm faqen jugore dhe perëndimore. Mbulimi i kishës bëhet nga një çati dy ujëse më kallkan në dy fasadat.

Absida është një thellim me seksion jo plotësisht gjysëm rrethor, brenda trashësisë së murit, i cili shërben si murë ndarës i ambjentit të kapelës dhe sterës. Në krahun verior të absidës ndodhet i thelluar në trashësinë e murit edhe protezis me seksion gjysëm rrethor, më i vogël nga ai i absidës. Porta e hyrjes është e mbuluar me hark guri dhe shpaulla me gurë të punuar. Qoshet e muraturës së kishës janë gjithashtu me gurë të punuar. Shpatullat dhe arkitrarët e dy dritareve janë me nga një gur gëlqeror të punuar. Në krahun e djathtë të dritares lindore ndodhet një reliev me qeramikë.

Kisha “Fjetja e Shën Mërisë” ndodhet në jug perëndim të kapelës së Shën Triadhës, fare pranë saj. Kisha është e tipit bazilikal mbuluar me çati druri dhe tavan të rrafshët. Ajo përbëhet nga; naosi, narteksi me dy kate, dhoma e pagëzimit, hajati perëndimor me dy kate, kambanarja dhe hajati jugor. Në ekstremin lindor të hajatit jugor ngjitur me kishën ndodhet një sterë me çezmën nga jugu.

Salla kryesore e kishës ndahet në tre anijata nga dy rreshta kolonash druri. Ambjenti i bëmës kufizohet nga ikonostasi, me një ngritje 10cm me lartë se salla. Absida ka formë rrethore nga brënda, në qendër të së cilës ndodhet një dritare e ngushtë. Nga të dyja krahët e absidës brënda, seksionit të murit, zhvillohen protezis dhe diakonikoni, në qendër ndodhet tavolina e altarit. Faqja lindore në të dyja anët e absidës ka edhe dy dritare të vogla. Në murin verior pranë linjës së ikonostasit ka një dritare frëngji. Salla kryesore e kishës ndriçohet nga 8 dritare të pozicionuara në nivelin e sipërm, përkatësisht 4 në anën jugore dhe 4 në atë veriore. Muri perëndimor ka katër dritare katërkëndëshe të vendosura dy e nga dy në nivelin e kateve të narteksit. Në faqen e jashtëme të dritareve në faqen veriore dhe jugore, mbi arkitraun e gurit, zhvillohen harqe me tulla e me gurë. Hapësira midis tyre është mbushur me dy pllaka tulle çerekrrrethore.

Struktura e çatisë përveç mureve anësore shkarkon edhe mbi kolonat e drurit. Tavani është i rrafshët me kuadrata të formuara nga listela të profiluara. Në qendër ka një rozetë, dekori i së cilës është i formuar nga ndërthurja drejtkëndëshash të profiluar.

Hyrtet për në naos janë tre, në faqen veriore, jugore dhe atë perëndimore. Dyshëmëja është e shtruar me pllakë drejtkëndëshë guri gëlqeror, me gjerësi jo më tepër se 0.6m. në qendër të dyshëmësë, nën rozetën e tavanit, ndodhet rozeta e dyshemesë me pllaka guri e organizuar brenda një kuadrati me tri rrathë koncentrikë.

Narteksi në katin e dytë zë tërë gjerësinë e naosit dhe të oborrit verior, ndërsa në katin përdhe mbetet i njëjtë me naosin. Dyshemeja e këtij kati, e njëjtë me dyshëmë e naosit, ruan po atë kuotë. Komunikimi i narteksit me mjedisin e jashtëm kryhet nga dy porta, në faqen jugore dhe perëndimore. Hyrja jugore ashtusikurse dhe dy hyrjet anësore të naosit, është realizuar vetëm me arkitrarë metalikë. Hyrja e faqes perëndimore nga brënda mbulohet me arkitra, ndërsa jashtë me harkë të dyfishtë guri të alternuar me tulla. Narteksi ndahet në tre pjesë, me anë të dy harkadave prej guri me nga dy harqe të mbështetura në murin e naosit dhe atë përballë tij. Muri perëndimor i narteksit përsa i përket vendosjes së dritareve dhe portës ripërsërit murin perëndimor të naosit. Kati përdhe dhe ai i parë i narteksit lidhen nëpërmjet një shkallë druri të pozicionuara në qoshen veri perëndimore të tij. Në anën jugore gjendet dhoma e pagëzimit me vaskën e pagëzimit prej guri, të pozicionuar në qendër të saj. Dhoma e pagëzimit është një katëshe dhe me hyrjen pranë murit perëndimor të narteksit.

Secila kolonë ka kapitele dhe jastik druri të cilat ashtu si dhe dyshemeja dhe çardaku në bllokun e hyrjes janë me dru lisi. Sipërfaqet e mureve, përjashtur faqen lindore të zbukuruar me afresk, janë të pa suvatuara. Në qendrën e faqes me pikturë afër dyshëmësë, ndodhet një nike e mbuluar me hark. Afresku nuk mbulon tërë sipërfaqen e murit, duke lënë pa prekur në pjesën më të madhe frontonin. Në linjën e sipërme dallohen pjesë të prera trarësh të dikurshëm. Dritaret e kësaj faqeje si në katin përdhe ashtu edhe atë të sipërm profilohen me gurë gëlqeror, me buzët e brendëshme të gdhendura imët. Hapja e dritareve është më e vogël së piktura, pasi ajo ndërpret skenat e kësaj të fundit.

Hajati perëndimor në katin përdhe, ka një harkadë e cila zë tërë ballin e objektit. Harqet janë më gurë gëlqeror të konturuar me shirit tullash dhe kapitelet janë të thjeshta pa ndonjë dekor të veçantë, veç tri shkallëzimeve të njëpasnjëshme.

Në anën jugore të hajatit ndodhet kulla e kambanares, me hyrje për çdo kat të hajatit. Kulla është ndërtuar shumë vonë, por me hedhjen e theksuar vertikale ajo zë një vend të veçantë në siluetën e kompleksit. Ajo ka një lartësi rreth 22m., me fasada të suvatuara, të cilat krijojnë në qoshe breza të profiluar. Në çdo kat ka një dritare për çdo fasadë. Në katin e fundit ku gjendet kambanarja, dritaret janë më të mëdha për të bërë të mundur përhapjen më të mirë të tingullit të kambanave. Levizja në kullën e kambanares realizohet nëpërmjet një shkalle me konstruksion druri. Dhe një shkalle me konstruksion metalik nga niveli i kambanave në taracën e kambanares. Hajati në fasadën jugore të kishës është njëkatësh. Arkada me gurë gëlqeror ka hap kolonash pak më të madh se në hajatin perëndimor. Kapitelet janë trajtuar më me shumë kujdes, të profiluar me gjethe apo rombe në relief në çdo qoshe. Kolonat cilindrike mbështeten mbi pllaka guri. Komunikimi me oborrin bëhet nëpërmjet një shkalle guri me planimetri gjysëm rrethore. Shtresa e dyshemesë është pjesërisht me pllakë guri të periudhës së parë ndërsa mbulimi bëhet më një çati një ujëse, linja e sipërme e së cilës kalon në nivelin e fundit të dritareve të naosit. Muratura e anëve lindore dhe veriore, të pa mbuluara nga ndërtime të tjera, është prej gurësh shtufi lidhur me llaç gëlqereje. Në të vihen re dy zona horizontale të dallueshme nga teknika dhe forma e gurëve. Linja e ndarjes së tyre përkon me xokolin e absidës. Pjesa e poshtëme që shërbente si bazament nuk është me gur të punuar. Në pjesën e sipërme gurët vendosën në rreshta horizontalme faqe pak a shumë të punuar. Qoshet e muraturës së kishës janë punuar me kujdes, me gurë gëlqeror. Me një përkujdesje mjaft më të madhe është ndërtuar absida, planimetria e së cilës mbi nivelin e xokolit është shtatë faqëshe, ndërkohë xokoli është gjysëm rrethor me gurë shtufi të papunuar. Pjesa tjetër e

absidës është ndërtuar më gurë gëlqerortë të gdhendur me kujdes. Faqet në pjesën qendrore kanë nike absidale të mbyllura sipër me harqe guri të alternuara me tulla. Më sipër vijon një rresht i alternuar me gurë e tulla, dhe së fundi korniza formohet nga gurë të profiluar e të shkallëzuar. Muri mbi absidë, meqënëse kisha ka çati dy ujëse, përfundon me fronton.

2.3 Sistemi i furnizimit me ujë

Territori i manastirit për vet pozicionin e tij në kuotën më të lartë të kodrës, nuk ka burime ujore. Në këto kushte nevojat për ujë janë përballuar duke krijuar katër stera për mbledhjen e ujit të shiut.

Stera pus është e pozicionuar në oborrin para hajatit perëndimor të kishës, kjo sterë është me hapje në formën e pusit nga sipër, ajo është e vetmja sterë që qëndron e shkëputur prej volumeve të tjera arkitektonike. Volum i saj ndahet në dy nivele: në depozitën nëntokë dhe pjesën mbi tokë. Depozita është katërkëndëshe e mbuluar me qemer cilindrik tulle. Planimetria e volumit mbi tokë është gjashtëkëndëshe. Tubacioni i qeramikës për prurjen e ujit ndodhej mbi një harkadë prej së cilës kanë mbetur dy harqet e para. Harkada vazhdon drejt lindjes.

Stera jugore e kishës së Madhe ndodhet në qoshen jug lindore të hajatit në fasadën jugore me dalje çezme në po këtë fasadë. Ajo ka një vëllim kubik të mbuluar më qemer të përfshirë nën çatinë e hajatit. Fasada e saj ndodhet në një rrafsh me atë të hajatit. Perballë saj gjendet mbulesa e portikut me dy harqe anësore dhe një ballor. Çezma ka një nike të mbuluar me hark të profiluar guri të kufizuar më një shirit tulle. Si thëmbra të hakut shërbejnë dy pjesë kornize antike. Pranë harkut ndodhet vrima e kontrollit të nivelit të ujit.

Stera ngjitur me kishën e Shën Triadhës, është pozicionuar në fasadën lindore të kishës së Shën Thanasit me daljen e një çezme në fasadën jugore. Ajo është e punuar me gurë të gdhendur, ka qenë e mbuluar me çati dy ujëse. Në pjesën fundore është vendosur një govatë ku mbidheshin ujërat. Brendësia e sterës dhe fugat e pjesës qendrore janë suvatuar me llaç shamot. Në faqen jugore, të pasuvatuar, ndodhet i murosur një reliev antik mermeri.

Stera e katërt është e pozicionuar në nivelin e dyshemesë së korridorit, në veri të narteksit me daljen e një çezme në fasadën veriore. Fasada e çezmës së stërës është trajtuar me kujdes, ku janë përdorur gurë e pllaka guri gëlqeror të puthitura shume mirë. Pjesa e saj qendrore trajtohet si nike.

Furnizimi me ujë realizohet nga çatia e kishës dhe e dhomave të këtij krahu nëpërmjet ullukëve prej qeramike.

3. FAZAT E NDËRTIMIT TË KONAKËVE.

Duke patur parasysh vrojtimet, sondazhet, si dhe mbishkrimet, do të përpiqemi të japim një radhitje të fazave ndërtimore.

Blloku i hyrjes, ku ndodhet data 1477, është pjesa më e vjetër e manastirit e ruajtur në lartësi. Terreni në këtë zonë është i qëndrueshëm dhe ka vuajtur më pak nga fenomeni i rrëshkitjes. Kësaj kohe i takojnë edhe muret rrënojë në vazhdim nga veriu dhe rrënojat në qoshen juglindore (Fig. 7).




Fig. 7 – Planimetrit e bllokut të hyrjes

Pjesa e poshtme e murit të portave të mjediseve jugperëndimore është më e hershme nga dy muret anësore. Kjo dallohet qartë nga nivelet e dyshemesë së dikurshme. Ky mur diferencohet nga arkada e kësaj pjese dhe së bashku me rrënojat në qoshen perëndimore e ato në pjesën e humbur nga jugu duhet t'i takojnë fillimit të shek. XVIII duke u lidhur në kohë me Kishën e Madhe. Në këtë faze manastiri arrin zgjerimin më të madh, të njëjtë me gjendjen e sotme. Në gjysmën e dytë të shek. XIX rindërtohet pjesa në veri të bllokut të hyrjes deri në zonën e furrave. Këtu bën përjashtim burgu i cili është më i hershëm dhe ka shërbyer, me sa duket, si sterë uji. Kështu manastiri mori thujse pamjen e sotme, përveç kullës së kambanares të ndërtuar në shekullin tonë.

3.1 Fazat e ndërtimit të kapelës së Shën Triadhës.

Nëpërmjet evidentimeve dallojmë katër faza ndërtimore. Në fazën e parë ekziston vetëm kapela e vjetër, hyrja e të cilës ka qenë nga perëndimi, kurse terreni jashtë, nga lindja e saj, përdorej si varrezë. Pas saj u ndërtua stera me gurë të një stere më të vjetër. Në fazën e tretë kapela u zgjatua deri te stera. U mbulua kapela e vjetër dhe u krijua e reja me dysheme tulle. Faza e fundit ka të bëjë me një rindërtim të vonë, i cili nuk e prek shumë formën planimetrike. Kisha e Fjetjes së Shën Mërisë është objekti ku është punuar më gjatë, si në arkitekturë ashtu edhe në objektet e artit. Fillimisht u krye ekzaminimi i strukturave mbajtëse dhe mbulesës. Themelet paraqiteshin në gjendje të mire, ndësa në mure dalloheshin dëmtime. Muri verior i naosit ka pësuar lëvizje rrotulluese për nga jashtë, duke krijuar një kurbëzim, thuajse në qendër, në nivelin e tavanit. Për të parandaluar zhvendosjet e mundshme në nivelin e trarëve të çatisë u vendosën tiranta hekuri. Dinamika e lëvizjeve, si në këtë mur, ashtu edhe në pika të tjera është patur nën kontroll. Po kështu vërehet ulja e absidës kundrejt pjesës tjetër. Ndaj saj nuk u bë ndonjë ndërhyrje pasi bazamenti rezultoi i qëndrueshëm.

Muri perëndimor i naosit, më i vjetri i kishës, kishte dëmtime më të mëdha. Kjo ishte shkaktuar nga ngarkesa e dyfishtë, nga çatia e naosit dhe e nartekstit, si dhe gjendja e tij e keqe fizike. Zonat më të dëmtuara qenë ato pranë dritareve. Kjo ka sjellë fryrjen e faqes nga narteksti, duke dhënë pasoja edhe në afresk. Në mungesë të materialeve konsoliduese, në formë rrëshirash, me të cilat do të injektohej muri në thellësi, u aplikua metoda e ribërjes. Në pjesën e dëmtuar muri u rindërtua, duke shkëputur paraprakisht afreskun. Pas ndërhyrjes afresku u rivendos. Për lidhjen e murit në gjatësi dhe shpërndarjen e njëtrajtshme të ngarkesave të çative mbi nivelin e sipërm të afreskut u vendos nje tra betonarmeje. Përveç rigjenerimit me lëndë lisi në hajatin perëndimor, prekjet e tjera patën karakter çlirues, evidentues dhe vlerësues. Në hajatat e shkallës u largua shtresa e çimentos dhe u riparuan shtresat origjinale. Në bazamentin e kolonadës në hajatin perëndimor u plotësua shtresa me tulla. Në katin përdhe të nartekstit u pastruan nga gëlqerja muret dhe harqet e gurit dhe u mbyll porta në qoshen veriperëndimore, si e vonë dhe e pavlerë. Fasadës së sterës jugore të kishës i mungonte mbulimi por forma e tij ishte plotësisht e qartë. Mungesa e këtij elementi ndihej në tërë unitetin e elementeve të oborrit. Duke pasur parasysh këtë dhe anën funksionale vendosëm që ai të riformulohej. Me realizimin e këtij elementi u vendos ekuilibër, jo vetëm në kuadrin e ngushtë të fasadës por edhe për tërë mjedisin. Në procesin e përkujdesjes futëm edhe kambanaren e cila nuk fsheh apo çënon ndonjë pjesë me vlerë. Sondazhet dhe punimet në truallin brenda dhe jashtë kishës pasuruan dhe sqaruan akoma më tej imazhin e saj arkitektonik. Në zonën para portës veriore të kishës me uljen e nivelit të dherave dolën mbetjet e një mjedisi. Nga sondazhet rezultoi se në murin verior, jugor dhe lindor të naosit ka gurë me copa afresku. Rrjedhimisht këtu është përdorur material nga mure të tjera me shtresë pikturë. Këta mure në pjesën e themeleve nuk lidhen me murin perëndimor. Interieri i naosit është i pikturuar në të katër faqet e tij, por në faqen perëndimore përveç kësaj shtrese pikturë ka edhe një tjetër të nënvënë. Shtresa e pikturës që duket mbulon tërë sipërfaqen e interierit dhe konceptohet në harmoni me elementet e arkitekturës. Katër dritaret e faqes perëndimore rrinë natyrshëm me skenat e afreskut. Ndërkohë këto dritare ndërpresin skenat e pikturës të nartekstit, çka tregon se piktura e fundit në naos është realizuar më pas. Pranë dyshemesë së katit të sipërm të nartekstit doli harku me tulla i një dritareje, i cili

qëndronte i fshehur nën pikturë. Kjo dallohet edhe në krahun tjetër. Sektori midis tij e arkitraut plotësohet me dy tulla çerek rrethi. Me heqjen e këtyre të fundit doli pjesa e prapme e afreskut të shtresës së parë në naos. Dy dritaret qëndrojnë simetrike me fasadën dhe portën. Kjo e fundit ka qenë më e lartë, me kulmin afërsisht në nivelin e dyshemesë së sipërme të nartekstit. Porta ekzistuese ruan të njëjtën gjerësi, ndërsa lartësinë e ka zvogëluar për tu përshtatur me katin përdhe të nartekstit. Sipërfaqja brenda linjës së fazës së parë të portës nuk është përfshirë nga piktura çka tregon se në kohën kur fasada që e pikturoar porta vazhdonte të kishte formën e saj origjinale edhe pse dritaret u mbyllën. Me pastrimin e sipërfaqes së gëlqeres u pa se piktura ka qenë e shtrirë ose ka vazhduar deri në pjesët e poshtme të muraturës. Në fasadën jugore të naosit janë përdorur jo vetëm gurë me copa afresku, por edhe suva shamoti. Gurë të tillë gjenden edhe në sofatin e hajatit. Pranë shkallës së hajatit dolën gjurmët e një stere uji, një pjesë e së cilës përfshihet edhe nga muri i harkadës. Konturi i jashtëm i saj është poligonal, ndërsa i brendshmi rrethor me diameter 2.60 m. Sondazhet treguan se stera aktuale qëndron e shkëputur nga kisha.

3.2 Faza e ndërtimit të kishës “Fjetja e Shën Mërisë”.

Vrojtimet tregojnë se ndërtimi i saj ka kaluar të paktën tri faza, të cilat kanë lënë gjurmë në murin perëndimor të naosit dhe lidhen me tri shtresat pikturore të kishës (Fig. 8).




Fig. 8— Planimetri; fazat e ndërtimit kisha e Fjetja e Shën Mërisë

Në fillim është ndërtuar volumi i naosit, planimetria e të cilit ka qenë e njëjtë më të sotmen. Në këtë fazë interieri që i pikturoar. Kjo pikturë haset në murin perëndimor dhe në gurët e ripërdorur. Muri perëndimor ka pasur dy dritare dhe portën e lartë. Fasada ka qenë e zhveshur pa pikturë. Në këtë fazë funksionin kryesor e kryente porta e madhe. Të kësaj kohe duhet të jenë edhe dy sterat; stera pus në oborrin perëndimor dhe stera rrënojë e cila padyshim ka pasur formë pusi.

Faza e dytë solli ndryshime vetëm në anën perëndimore, ku fasada u pikturoa duke bllokuar dy dritaret. Porta e madhe vazhdoi të qëndrojë e pandryshuar. Në këtë fazë ndërtohet një hajat

i hapur prej druri, gjurmët e të cilit shfaqen në konfiguracionin e pikturës dhe mbeturinat e trarëve të konstruksionit të sipërm.

Në fazën e tretë ndryshimet janë të mëdha. Muret veriorë, lindorë dhe jugorë të nartekstit u ringritën nga themeli duke lënë gjurmë fare të pakta në qoshen verilindore. Ky veprim mund të gjejë justifikim vetëm në njohjen e dobësisë së mureve të vjetra. Në këtë mënyrë humbi edhe piktura e këtyre tri faqeve, ndërkohë që ajo e faqes perëndimore vazhdoi të ruhet së bashku me murin. Me ribërjen e tri faqeve të naosit në murin perëndimor u hapën katër dritare, të cilat ndërpresin pikturën e nartekstit. Ndarja në dy kate e nartekstit solli reduktimin e lartësisë së portës së madhe. Narteksti shoqërohet me hajatin perëndimor. I kësaj faze është edhe hajati jugor së bashku me sterën. Ndërtimi i hajatit e prish sterën-pus të kësaj ane duke ripërdorur një pjesë të materialit të saj. Kjo faze datohet me pllakën e vendosur në hajatin perëndimor. Në këtë mënyrë kisha mori pak a shumë pamjen që ka edhe sot, me përjashtim të disa ndryshimeve të vona si: ndërtimi i murit me tulla në katin përdhe të nartekstit, ndërtimi i kambanares etj.

3.3 Datimi

Nuk dihet pikërishtë kur u ndërtua ky manastir, pasi nuk ekzistojnë të dhëna të sigurt historike. Shumë nga studiuesit, apo udhëtarët që kanë parë manastirin, i drejtohen gojëdhanës se ai është themeluar në kohën e despotatit të Epirit, në shek. XIII, pa sjellë të dhëna materiale e dokumentare. Në dokumentet historike, përmendja më e hershme e manastirit “Fjetja e Shën Mërisë” në Ardenicë, i përket vitit 1715. Një nga botimet më të herëshme ku përmendet manastiri është edhe “Përshkrimi i Mitropolisë së Shenjtë të Beratit dhe zonave në varësi të saj” shkruar nga mitropoliti i Mitropolise së Beratit Anthim Aleksudhi botuar në vitit 1868, Korfuz. Në këtë vepër në Kreun IV autori bënë një përshkrim të manastirit ku citon se manastiri mund të jetë ndërtuar prej hegjemonisë perandorake të kujdestarëve, despotëve dhe dukëve të Konstandinopojës në Epir dhe Shqipëri. Vetë objekti ofron disa mbishkrime. Data më e vjetër është ajo që ndodhet në ballin e brendshëm të hyrjes së manastirit, ku në gjuhën greke shkruhet 1 Maj 1477. Mbishkrimi në brendësi të naosit, mbi portën kryesore, jep datën 1743-1744, kohë në të cilën kisha pikturohet nga vëllezërit Kostandin dhe Athanas, nga Korça. Një pllakë guri në ballin e hajatit perëndimor të kishës jep datën 1754, ndërsa pllaka prej guri, në harqet e mbetura të furrës daton 1770. Në kishë gjendet një ikonë e Shën Mërisë e vitit 1731 dhe një tjetër e pikturuar nga murg Simoni i këtij manastiri, shek. XVII. Deri në vitet tridhjetë të shekullit tonë në kishë gjendej një këmbanë e madhe me datën 1738. Një tjetër gojëdhanë flet për celebrimin në këtë kishë të Skënderbeut në vitin 1451.

Nga këto të dhëna del se ky kompleks ekzistonte përpara Kishës së Madhe. Kjo e fundit është ndërtuar Brenda viteve 30 deri 40 të shek. XVIII. Faza e tretë e saj i përket vitit 1754, sipas mbishkrimit që gjendet në hajatin perëndimor. Sipas studimeve të pikturës murore, shtresa e dytë e saj në naos i takon autorëve të fazes së parë, ndërkohë që mbishkrimi dhe data e saj janë lënë të dukshme mbi hyrjen. Ikona e vitit 1731, përmendja në vitin 1715 nga dokumente kishtarë dhe ikona e murgut Simon të këtij manastiri, e shekullit të XVII, e shtyn në kohë ndërtimin e kishës së manastirit. Por për tu shtyrë më tej nuk gjejmë ndonjë të dhënë përveç datës 1 Maj 1477 dhe rrënojave të kapelës së vjetër të Shën Triadhës. Kapela e Shën Triadhës

është më e hershme se gjithë strukturat e tjera, shumë më e vjetër nga stera ngjitur, e cila i takon gjysmës së parë të shek. XVIII. Këtë e tregon përdorimi i gurëve të sterës së prishur në hajatin jugor të Kishës së Madhe. Terreni ku u ndërtua kjo e fundit përdorej si varrezë e kapelës. Varreza është bashkëkohëse e kapelës, sepse themelet nuk kanë dhunuar ndonjë varr, siç ka ndodhur me sterën. Është gjithashtu e kuptueshme se stera nuk mund të ndërtohej mbi varre të rinj. Përkundrazi, këta duhet të kenë qenë kaq të vjetër, sa të ishin harruar ose të paktën të mos dalloheshin në kohën kur u vendos të ndërtohej stera. Për një kohë të hershme tregon edhe analiza e materialit ndërtimor. Përveç strukturës së mureve tullat i përmbahen një standarti të njëjtë me atë të kishës së Ristozit të shek. XIII-XIV. Ky element nuk është aq i fuqishëm sa të fiksojë datën e themelimit të kishës. Por duke marrë parasysh datimin e varrezës në pragun e mesjetës së mesme, sipas analizës antropologjike, do të anonim më tepër për një datim në shek. XIII-XIV, në këtë drejtim, ndonëse Ristozi ndodhet larg. Duke u nisur nga të dhënat që kemi, mendojmë se manastiri i Ardenicës e filloi jetën në shek. XIII-XIV. Data e mbishkrimit të hyrjes 1477 është e pazakontë pasi në këtë periudhë ndërtimet e reja janë minimale, për të mos thënë se u ndërprejnë.

3.4 Teknikat e ndërtimit.

Teknika e ndërtimit e përdorur në kompleksin është e thjeshtë. Zgjidhjet konstruktive janë të njohura edhe në arkitekturën e banesës popullore. Në strukturat mbuluese është përdorur harku dhe qemerit. Ka shumë mundësi që stera-rrënojnë të ketë qenë e mbuluar me kupolë. Harqet në shumicën e tyre janë realizuar me gurë gëlqeror. Skema e vendosjes është mjaft e efektshme, pasi jep mundësi të shfrytëzohen gurë me profile jo shumë të mëdha, duke realizuar në të njëjtën kohë një lidhje të qëndrueshme zinxhir, me vendosje në formën e gërmës T që përsëritet. I njëjti parim ndiqet edhe në ballet e qemerit të hyrjes. Bëjnë përjashtim, si përsa i përket llojit të gurit, ashtu edhe skemës së vendosjes, harqet e mjedisit të mullirit dhe ato në katin përdhe të segmentit jug-perëndimor, ku vendosja e gurëve shtufor në seksion është e thjeshtë dhe në faqen e brendshme të harkut fugat vertikale janë të alternuara. Harqet e arkadave kanë në konturin e sipërm një shirit me tulla (përjashtuar harqet në brendësi të nartekstit, mullirit dhe ato të katit përdhe të krahut jug-perëndimor). Harqet mbështeten gjithnjë në gurë të plotë të profiluar, të cilët dalin nga planet e faqeve të harkut. Në rastin e arkadave me kolona cilindrike mbështetja bëhet në kapitete të thjeshta. Formues i harqeve është gjithmonë gjysmërrethi, përjashtuar këtu qemerin e hyrjes kryesore, që është më i shtrirë. Në asnjë rast nuk theksohet çelësi i harkut. Gurët gëlqeror përdoren në pjesët që kërkojnë përpunim të veçantë, si harqet, qoshet e mureve, shpatullat dhe arkitrarët e dritareve, absiden e kishës me tërë elementet e saj. Ky lloj guri preferohet për gdhëndjen e lehtë, por ndërkohë përdoret me ekonomi, pasi kavat e tij janë largë, kurse guri i shtufit gjendet pranë, në vetë kodrën e Ardenicës. Tullat përdoren si element konstruktiv në qemeret, si elemente dekorative në harqet, si shtresë dyshemeje, në kornizat dhe zonën e sipërme të dritareve të kishës së madhe. Mbulimi i mjediseve të kateve të sipërme është me konstruksione druri. Ndarjet e mjediseve janë me çatma. Themelet janë vazhdimi i mureve pa ndonjë zgjerim. Nga pikpamja e konsistencës për cilësi më të mire dallojnë pjesët më të vjetra, si rrenojat në qoshen perëndimore të konakëve. Në Kishën e Madhe ndodh e kundërta.

4. RESTAURIMET DHE SONDAZHET NDËRVITE

Ndërhyrjet në kompleksin e mansatirit ndër vite të kryera nga IMK, kanë pasur si qëllim kryesor konsolidimin e strukturave, evidentimin e fazave ndërtimore, eliminimin e ndërhyrjeve të gabuara, të cilat pengonin leximin e objektit si dhe vënien në funksion të të gjitha ambjenteve të tij si një kompleks. Punimet restauruese u realizuan me qëllim edhe dhënien e një funksioni të ri të këtij manastiri si hotel turistik.

4.1 Ndërhyrjet në konakë

Ndërhyrjet restauruese të konakëve, nisur me ritëm të ngadaltë në vitet 70, prekën fillimisht vetëm qoshen jug-perëndimore dhe perëndimore, duke riparuar çatinë dhe dyshemenë e tyre. Më vonë ndërhyrjet u përshpejtuan në kohë duke u rritur edhe në vëllim. Këto ndërhyrje synuan në preken e gjithë kompleksit të manastirit.

Konakëve, veçanërisht atyre të pjesës lindore, krahas ndërhyrjeve konservuese në strukturë, i'u evidentua forma dhe pjesët e panjohura arkitektonike. Të tilla ishin: çardaku i hyrjes në fasadën nga oborri, korniza, dy portat në qoshen që formon bllokun e hyrjes me dhomën nga veriu, dyshemeja e vjetër në këtë dhomë e shtuar me tulla të pjekura, muret rrënojë në mjediset përdhese, si dhe gjurmët e shkallëve të kunetave të vjetra. Të gjitha këto elemente që lidhen ngusht me historinë ndërtimore të manastirit u lanë të dukshme dhe u konsoliduan. Dy portat e murosura u hapën dhe u plotësuan në bazë të gjurmëve. Po kështu mbi bazën e gjurmëve u riformua korridori si dhe ballkoni në fasadën e jashtme. Riformulimi i tyre i bazuar në gjurmët e sigurta, nuk fshehën ose dëmtuan elementë e gjurmë të tjera. Me restaurimin e këtyre elementëve mjediset filluan të komunikojnë si në fazën fillestare të manastirit. Çardakut i'u pastruan e konservuan elementët e mbetur. Tavanët prej druri u konservuan dhe u plotësuan në pjesën që mungonin, në dhomën e pritjes dekori u realizua sipas pjesëve të ruajtura. Dhomat me tavan me suva me kallama u risuvatuan, por me rrjet teli. Elementët përbërës të interiereve; dyert, dritaret, dollapët, sergjenët dhe fashaturat u ruajtën në gjendjen origjinale duke plotësuar vetëm pjesët ku mungonin. Gjurmët e dyshemesë së vjetër me tulla u konservuan ndërsa pjesa tjetër u shtrua me tulla të reja me përmasa 25x25cm., që i afrohen përmasave origjinale 26x30x4cm., ndërsa dyshemetë e drurit nuk u prekën.

U kryen ndërhyrje konservuese në gjithë muraturën e konakëve. Problem të karakterit konstruktiv pati vetëm një pjesë e murit të jashtëm të dhomave në fasadën jugore, i cili shfaqte epje për nga jashtë. Më të ndjeshëm këtë problem e kishtë bërë humbja e aftësisë majtëse të kontrafortëve. Si masë përforcuese u vendosën tiranta metalik në nivelin e dyshemesë, të cilat lidhën murin e dëmtuar me dy muret e brendëshme, si dhe u krye pastrimi dhe injektimi me leng gëlqereje i zonës ku muri kishtë shpërbërë dhe degradim të llaçit. Kontrafortit ju përforcua tabani me themel butobetoni dhe u vendosën katër unaza metalike përgjatë kontrafortit. Në kontrafortet e rrënuara, të cilat dolën në dritë pas uljes së nivelit të dheut, u kryen punime konsolidimi.

Ulja dhe kërkimi i nivelit origjinal të kalldrëmeve dhe dyshëmeve, solli në dritë element me vlerë. Në qoshen perëndimore përveç mureve të mjediseve të rrënuara, doli hyrja e dytë e manastirit. Gjatë gjurmëve u vunë re disa nivele djegieje, 30-40 cm. largë njëra -tjetrës. Në

qoshen jug-linode të konakëve dolën dy mure të ngjitur tërthor mjedisit, me vrima ku shkarkontë kuneta e ujit. Nga sondazhi u pa se këto dy mure janë të lidhura me pjesën e bllokut të hyrjes. Pas tyre në drejtimin nga jugu themeli ulet shumë. Po kështu në mjediset e katonjëve dhe mullirit dolën struktura të vjetra muresh.

Nga gërmimet u bë e qartë se manastiri ka pasur problem me terrenin e pjerrët përreth tij, për këtë arsye largimi ujërave sipërfaqësor është organizuar me kujdes dhe zona me tëpër rrezik është paisur me kontrafortë.

Me funksion e ri, si hotel turistik, u lidhën edhe disa punime të veçanta. Ana funksionale e ripërdorimit të ri respektoi skemën e vjetër të manastirit. Në bllokun e hyrjes u vendosën dhoma e pritjes, restoranti dhe kuzhina në veri të saj, kafetëria veranda dhe bari i hapur në krahun tjetër. Pas kuzhinës vazhdojnë: magazine frigorifer dhe dhoma fjetjeje, të cilat shkojnë gjatë krahut verior deri tek furra e vjetër. Përveç dhomave të fjetjes, një pjesë e mirë e të cilave u pajis me banjo, u punua për realizimin e një muzeu tek mulliri i vajit dhe taverna në mjediset përdhese në anën jugore të manastirit. Në pjesën e katojve dhe të mullirit të vajit doli e domosdoshme eliminimi dhe parandalimi i lagështisë, për shkak të nivelit të lartë të dherave nga ana e oborreve. Për këtë arsye u realizua një drenazhim i thellë dhe dyshëmëtë u hidroizoluan. Në mjediset e pritjes dhe në restorant u realizuan disa oxhakë, në vendet ku ka patur të tillë. Sipas funksionit, në përshtatje me frymën e arkitekturës së manastirit, u vendosën ndriçues të tipave qirinj, shandanë apo fenerë. Këto të fundit u vendosën në hajat, oborr e korridor.

Qëndrim vlerësues si dhe restaurues u mbajtë edhe për mjedisin rrethues të manastirit. Në këtë ide bën pjesë ndërtimi i rrugës për në manastir, nëpërmjet së cilës lehtësohet mjaft frekuentshmëria, si dhe u realizua pyllëzimi përreth monumentit.

4.2 Ndërrhyrjet në kishat.

Ndërrhyrjet restauruese në kishat e manastirit u lidhën me synimin për të kërkuar gjurmë më të vjetra, si dhe për përcaktimin e renditjen e fazave ndërtimore të tyre. Në këtë gjë na nxiti dhe gojëdhana për themelimin e manastirit gjatë despotatit të Epirit, shek. XIII- XIV. Nga strukturat mbi sipërfaqen e tokës nuk dallohet asnjë gjurmë e kësaj periudhe. Ndaj edhe barra kryesore i ngeli sondazheve.

Kapela e Shën Triadhës pjesët mbi nivelin e tokës dhe një pjesë të vogël të sterës i ka të rindërtuara 50 vjet më parë. Në përgjithësi gjendja e saj fizike është e mirë, me përjashtim të faqes veriore, e cila për shkak të rrëshqitjes, ka krijuar çarje në të dy qoshet. Pas riparimeve të çatisë nisëm kontrollin në thellësi. Gërmimi u krye me shtresa 20 cm. Materiali i nxjerë përbëhej nga mbeturina ndërtimore, llaçra e copa tulle.

Rreth 30 cm më poshtë nivelit të sotëm, në qoshen jug-perëndimore, doli shtresa me tulla (27x27x3.5 cm) e dyshemesë para rindërtimit të fundit, e vendosur mbi llaç të varfër gëlqereje. 75 cm më poshtë doli niveli i dyshemesë fillestare edhe kjo shtruar me pllaka tulle 28x18x4.5 cm mbi llaç gëlqereje. Rreth 1 m larg murit lindor doli muri i vjetër me gjerësi 0.73 m dhe lartësi 0.50 m. Në dyshemenë e kësaj faze duket gjurma e bazës së ikonostasit prej druri. Në kanalin e tij dallohen gjurmët e djegies. Pjesa e altarit e ka dyshemenë më të ngritur kundrejt pjesës tjetër. Ndësa për të kaluar jashtë, në nivelin e oborrit, shërbejnë dy këmbë shkallë. Me thellimin e terrenit në hapësirën midis kishës së vjetër dhe sterës, nuk doli

ndonjë material i cili do të lejonte datimin e kapelës, përveçse skeletë. Skeleti i sterës që i vendosur me kokë nga perëndimi dhe thuajse tërë trupin e kishte poshtë themeleve. Muri perëndimor i sterës ka në përbërjen e vet gurë të ripërdorur me suva shamoti, kurse muri rrënojë nuk ka suvatim. Nga elementet përbërës që lidhen me ritualin nuk ka gjurmë, pasi rrënimi ka ndodhur në nivelin e tyre, por është e qartë se absida ka qenë e zhvilluar brenda seksionit të murit. Muri i veriut, në anën e dëmtuar nga rrëshqitjet, është i ri. Gjendja pas gërmimeve, do të ruhet si e tillë duke bërë vetëm ndërhyrje konservuese. Duke qenë në mjedise të mbyllura kjo lehtëson mjaft. Fasada lindore e sterës u pastrua nga gëlqerja dhe u mbushën fugaturat.

5. GJENDJA EKZISTUESE E MONUMENTIT DHE NDËRHYRJET RESTAURUESE QË PROPOZOHEN

Nga vëzhgimet që u kryen gjatë ekspeditës së kryer në datë 05.05.2021 nga specialistë të IKTK-së u konstatuan disa probleme strukturore dhe degradime të monumentit si më poshtë:

5.1 Të përgjithshme

- Automjetet mund të futen deri në shesh parkimin e Manastirit rreth 60 m larg portës hyrëse të manastirit.
Mansatiri ka vetëm një portë hyrëse për vizitorët, e cila të çonë në oborrin e manastirit prej nga mund të vizitosh ambjente të ndryshme të tij. Hyrjet e tjera dytësore janë përgjatë katit përdhe të konakëve dhe janë përgjithsisht të mbyllura dhe shërbejnë vetëm për personat që administrojnë manastirin.
Në të dyja krahët e portës hyrëse (në fasadën lindore dhe atë jug-perëndimore) janë vendosur dy porta me kornizë hekuri ndërthurur me tel gabioni të cilat vazhdojnë me rrethim teli gabioni në thellësi të pyllit duke penguar cdo person të vizitojë ambjentin përreth manastirit.
- Përgjatë gjithë mureve perimetralë të konakëve e në veçanti atyre në fasadën jug-perëndimore dhe pjesërisht veriore ka shumë probleme strukturore që vijnë si rezultat i terrenit të thyer.
- Aktualisht kati përdhe i konakëve është i pa shfrytëzuar.
- Instalimet elektrike janë pjesërisht të degraduara, në podrume ato mungojnë fare. Muret e manastirit nuk ndriçohen gjatë natës, nuk ka ndriçim të jashtëm.
- Instalimet hidraulike si dhe sistemi i kanalizimeve dhe ai i ngrohjes nuk janë në funksion.
- Sterat e ujit të manastirit nuk janë funksionale.
- Nga roja i manastirit na u komunikua se gjatë dy viteve të fundit ka patur tentativë për vjedhjen e manastirit, duke qenë se nuk ka një sistem sigurie.
- Përgjatë rrugës rurale që të çonë në manastir, mungojnë tabelat orientuese. Në Manastir mungon tabela informuese e monumentit.
- Mungojnë tabelat e emërtimeve të pjesëve përbërëse të këtij manastiri (pusi, konakët, dhoma e pritjes, mulliri, kuzhina, etj)
- Hapësira e dedikuar për parkimin e automjeteve, jashtë Mansastirit është e asfaltuar por e pa organizuar me ndarjet përkatëse.

- Përveç shërbimeve të tualetit, restauruar së fundmi, brenda monumentit mungon një pikë ku të ofrohet ndihma e shpejtë duke qenë se qyteti më i afërt është 16.8 km larg.
- Lehtësirat për vizitorët me aftësi të kufizuara mungojnë.

5.2 Kishat

Kisha e Shën Thanasit

Nga sondazhet që janë realizuar në vitet 80 janë evidentuar 4 faza ndërtimi. Gjendja aktuale e kishës është edhe faza e fundit e ndërtimit që daton rreth viteve 30-40. Në vitet 80 janë realizuar një sërë ndërhyrjesh restauruese, si përforcimi me kontrafort i murit verior i cili ka patur probleme statike, çlirimi i fasadës perëndimore nga suvatimi, fugatime murature vendosje dyer dritare, konsolidimi i dyshemesë dhe restaurimi i çatisë.

Aktualisht kisha është në gjendje të mirë nga ana konstruktive, ikonostasi është i ri si dhe dyshemeja është e shtruar me pllaka gres në ngjyre kafe të errët (Fig.9).



Fig. 9– Pamje e ikonostasit të ri



Fig. 10– Pamje e fasadës perëndimore



Fig. 11– Pamje e fasadës juore

Kisha "Fjetja e Shën Mërisë"

Kisha ka patur një ndërhyrje restauruese të thellë pothuajse në të gjitha elementët e saj përbërës gjatë viteve 80 nga specialist të IMK-së. Aktualisht, në tërësinë e saj ajo paraqitet në gjendje shumë të mirë konstruktive.

- Nga sa u konstatua në vend u verejt që piktura murale është në gjendje të mirë por ka nevojë për një pastrim sipërfaqësor.

- Përgjithësisht gjithë struktura drusore e narteksit dhe sidomos ajo e hajatit perëndimor ka nevojë për tu trajtuar me solucion anti molë dhe me vaj lini.

- Siç mund edhe të shihet nga fotot (Fig. 12, duke qenë se dita gjatë ekspeditës ka qenë me shi) gjithë pjesa fundore e muraturës ka kapilaritet të ujërave sipërfaqësor i cili ka krijuar degradimin e fugave si dhe krijimin e njollave të zeza në fasadë.

- *Propozohet pastrimi i fugave të degraduara përgjatë gjithë perimetrit të kishës (deri në një lartësi rreth 1m nga toka) në mënyrë mekanike me furçë teli dhe uji, dhe rifugatimi i tyre me llaç hidraulik.*

- *Aplikimi i rezinës transparente në fasadë, pasi të jetë realizuar rifugatimi.*

- *Pastrimi i fasadës (muri verior i narteksit) nga patina biologjike.*

- Kambanarja është restauruar sëfundmi (në vitin 2007-08), struktura drusore e saj në nivelin e sipërm, duke qenë se është në kontakt me agjentët atmosferik si uji i shiut dhe era.

- *Propozohet trajtimi me vaj lini dhe anti insekticid i gjithë strukturës drusore si dhe trajtimin e elementëve metalik me solucion kundër ndryshkut (Fig. 18).*



Fig. 12— Pamje e fasadës juore

- *Propozohet restaurimi i dyshemesë së narteksit.*
- *Trajtimi me vaj lini dhe anti insekticid i gjithë strukturës drusore, dyerve dhe dritareve dyshemeve, harkadës, tiramntave të drurit.*
- *Propozohet trajtimi i elementëve metalik me solucion kundër ndryshkut (zgarat e hekurit në dritare).*
- *Pastrim të fugave të degraduara apo edhe të pa përshtatshme (llaç çimento) në murin verior mbi ullukun vertical të gurit. Rifugatim me llaç hidraulik dhe lyerje me rezinë transparente.*

- Veshja nga ana e sipërme e ullikut të shkarkimit ekzistues, prej guri me fletë plumbi, në mënyrë të tillë që kjo fletë të shërbejë si ulluk shkarkimi horizontal i cili do të shkarkoj në ullukun vertikal me anë të një gote shkarkimi (shih detajin grafik) Fig.17.



Fig. 13– Pamje të pikturës murale




Fig. 14– Pamje të narteksit; kati i përdhe

Fig. 15– Pamje të narteksit; kati i pare



Fig. 16– Pamje, fasada lindore



Fig. 17– Pamje, fasada veriore



Fig. 18 – Kambanarja pamje e traut ku varen kambanat

- Nga vëzhgimet e specialistëve të IKTK-së u konstatua se qoshja veri-perëndimore e narteksit ka një çarje vertikale e evidentueshme si nga ana e brendëshme ashtu edhe nga ajo e jashtme. Siç mund të shihet nga foto (Fig.20) kjo çarje ka qenë fugatuar me llaç. Rihapja e kësaj çarje tregon që ajo është ende aktive. Nga një vëzhgim më i detajuar u konstatua se muri verior i narteksit, dhe me konkretisht paret e jashtëm të tij ka një epje për nga jashtë që vjen si rezultat i infiltrimit të lagështisë që bie nga çatia (e cila del rreth 15 cm jashtë murit të

kishës) duke qenë se ky mur ka disa faza ndërtimit me trashësi të ndryshme, pjesa e poshtme e tij del më jashtë strehës së çatisë (Fig. 20).

- *Propozohet konsolidim i mur të gurit me teknikën e injektimit.*

Ky proces do të realizohet me injektimin e llaçit hidraulik në strukturën murale të kishës.

***Injektimet.** Injektimet do të kryhen në të gjithë muraturën veriore të narteksit (mbasi janë bërë fugatimet). Mbas pastrimit të muraturës nga llaçi i dekompozuar dhe para fugatimit vendosen tubat që do të shërbejnë për injektim dhe lahet muratura, si nga jashtë, ashtu dhe brendësia e saj nëpërmjet tubave të injektimit. Tubat do të jenë 1/2" dhe do të vendosen 2-4 copë/m² dhe 25-30 cm në thellësi të muraturës.*

Llaçi i injektimit do të përbëhet prej materialesh tradicionale dhe me rezistencë jo më të madhe se llaçi i shëndoshë i muraturës, për të shmangur rrezikun e krijimit të bërthamave rigjide brënda masës së muraturës. Injektimi do të kryhet me gravitacion, d.m.th. me vetërrjedhje dhe në një drejtim, duke filluar nga pjesët e poshtme të muraturës dhe duke u ngjitur në lartësi, (në qoftëse do të shikohet e nevojshme nga specialistët gjatë punimeve mund të bëhet edhe injektim me presion).



Foto 19. Shëmbull i procesit të konsolidimit të muraturës

Injektimet për konsolidimin dhe kompaktësimin e muraturës, në këtë rast mund të bëhet nga të dyja anët e muraturës.

Ky proces do të kryhet nga specialisti restaurator në prezencë të mbikqyrësit të punimeve.

Përbërja e llaçit pa kimikate:

<i>Rërë lumi e larë</i>	<i>2 pjesë</i>
<i>Rërë vullkanike me granulacion 0,5-1 cm</i>	<i>2 pjesë</i>
<i>Pluhur tulle e çmërçi dhe copa tulle deri në 2 cm</i>	<i>2 pjesë</i>
<i>Gëlqere e vjetër</i>	<i>3 pjesë</i>

Fazat e zbatimit të injektimit

- 1. Prgatitja e sipërfaqeve. (Pastrimi i fugave dhe larja e muraturës).*
- 2. Stukimi i fugave dhe të gjithë të çarave, për të evituar rrjedhjen e llaçit nëpërmjet stukimit me lidhës koerent me llaçin e injektuar. Do përdoret një llaç me bazë të gëlqeres idraulike natyrale.*
- 3. Realizimi i rrjetës së injektimit. Bëhet hapja e vrimave në muraturë (2-4 vrima për m²) me diametër ϕ 1.5-2.5cm.*
- 4. Pozicionimi i tubave (ϕ 1-2 cm), me thellësi mesatare 50-60cm.*
- 5. Insertimi (në rast se do jet i nevojshëm me presion) i llaçit me bazë të gëlqeres idraulike natyrale të hiperventiluar (presion 1,5 atm - 3 atm).*
- 6. Heqja e tubave dhe stukimi i vrimave.*



Fig. 20 – Pamje e qoshes veri-perëndimore të narteksit, muri verior i narteksit

Sistemi i furnizimit me ujë

Aktualisht asnjë nga sterat që kanë shërbyer për furnizimin më ujë të manastirit nuk është funksionale. Ambjentet e manastirit, si tualetet në çdo dhomë dhe kuzhina furnizohen me ujë nga një depo e vendosur në fasadën veriore të kishës së madhe mbi një platformë metalike. Kjo depozitë, plastike, mbushet me anë të një pompe uji nga një depozitë nëntokësore e ndërtuar rishtazi nga kisha. Depozita e vënsosur në një farë lartësie rreth 5-6 metër nga niveli i tokës është e dukshme nga larg në siluetën e manastirit duke krijuar një pamje jo të këndshme për vizitorët (Fig. 21).

- *Propozohet heqja e kësaj depozite dhe furnizimi i të gjithë tualeteve direkt nga depozita nëntokësore me pompë.*



Fig. 21 – Pamje e depozitës së ujit dhe e çezmës së sterës në anën veriore të kishës së madhe

5.3 Konakët




Fig. 22– Kati përdhe, ndarja e planimetrisë në seksione

Në Fig.22 është bërë ndarja e planimetrisë së konakëve të manastirit në seksione për të bërë më të lehtë dhe më të kuptueshme problematikat të cilat do të trajtohen dhe propozohen për restaurim në këtë projekt. Planimetria e konakëve është ndarë në 5 seksione përkatësisht:

- Seksioni “A”- Konakët në krahun veri – perëndimor
- Seksioni “B” - Konakët në krahun jug – perëndimor
- Seksioni “C” – Konakët në krahun jug – lindor (Hyrja e manastirit)
- Seksioni “D” – Konakët në krahun lindor dhe veri -lindor
- Seksioni “E” – Konakët verior (pjesa çfarë ka mbetur prej tyre)

Në vitet 80 janë kryer ndërhyrje konservuese në gjithë muraturën e konakëve.

Seksioni “A”

Muratura - Gjatë ndërhyrjeve që janë kryer për përshtatjen e konakëve për hotel në këtë seksion, janë bërë tualete për çdo dhomë. Çdo tualet ka instalimet e veta të drenazhimit të ujërave të zeza, që dalin në fasadën e monumentit në një mënyrë aspak të hijëshme. Për daljen e çdo tubacioni është krijuar një zgavër në muraturë që është lënë e hapur ose është zënë me gurë dhe tulla në një mënyrë të çrregullt duke krijuar kështu kaos në strukturën murale të monumentit. Pjesa fundore e disa prej këtyre tubacioneve të drenazhit përfundon në nivelin e tokës dhe nuk duket të jetë e lidhur me sistemin e drenazhit (Fig.23).




Fig. 23– Pamje e bubacioneve të kanalizimeve të ujërave të zeza

- *Propozohet heqja e këtyre tubacioneve dhe spostimi i tyre nga krah i brendëshëm i murit, dhe nxjerrja jashtë e tyre në nivelin e nëntokës ku çdo njëra do të këtë një pusetë të vogël shkarkimi ku me anë të tubacioneve nëntokësore do të mblidhen në një pusetë më të madhe dhe do të largohen nga manastiri drejtë gropës septike që ndodhet në përfundim të tij.*
- *Mbyllja e kaviteteve në muraturë me gurë dhe llaç.*
- *Pastrimi mekanik i fasadës nga fugatimi i degraduar dhe ri fugatimi.*

Në qoshen veri perëndimore të konakëve vërehet një çarje nga poshtë lartë e paretit mural në fasadën veriore. Duke gjykuar nga forma e çarjes, hapja, mendojmë se është shkaktuar nga rrëshkitja e tërrënit dhe në vitet 80 është bërë përforsimi i bazamentit (Fig.24).

- *Propozohet qepja e çarjes me teknikën e injektimit*
- *Për të përforsuar muraturën propozohet ngritja e një kontraforti në anën veriore të konakëve (shih detajin grafik) me të njëjtën teknikë dhe dimension si ai ekzistuesi në anën perëndimore.*



Fig. 24 – Pamje e qoshes veri perëndimore

- Dritare

Në pjesën veri-perëndimore të konakëve shihen shumë dritare të tamponuara rishtazi (punime të kryera nga kisha) me tulla nga ana e brendëshme e tyre, duke krijuar kështu një pamje aspak të këndëshme dhe një tjetërsim të fasadës (Fig.25).

- *Propozohet hapja e këtyre tamponimeve duke e kthyer në identitet fasadën;*
- *Gjatë këtyre punimeve do të realizohet edhe F.V. dritare druri me të njëjtin konfigurim si ekzistueset;*
- *Restaurim i arkitrarëve dhe parvazeve të drurit;*
- *Lyrje me bojë antiruxh i gjithë kangjellave metalike.*



Fig. 25 – Pamje e fasadës veri të konakëve

- Harkada e konakëve

- *Propozohet trajtimi i strukturës drusore të harkadës së konakëve me vaj lini, dhe anti insekticid.*
- *Shtrimi me pllaka guri në ngjyrë grit i harkadës në katin përdhe.*
- *Pastrim i fugave të degraduara në mënyrë mekanike në gjithë muraturën e shkallëve dhe rifugarim me llaç hidraulik.*
- *Pastrim i fugave të degraduara në mënyrë mekanike në gjithë muraturën e harkadës nga ana e jashtme, në katin përdhe dhe rifugarim me llaç hidraulik.*

Më tej linja e ambjenteve të konakëve të seksionit “A” thyhet, dhe dhomat që pasojnë në drejtimin lindor spostohen për më në lindje (Fig.26). Dy mjediset të këtij segmenti janë përdorur si furrë pjekje të cilat sot janë në gjendje jo të mire dhe përdoren si magazinë.




Fig. 26– Pamje të hyrjes për tek furra e pjekjes

Fasada nga oborri i këtij ambjenti ka qenë me arkadë guri, prej së cilës ruhen vetëm dy harqe. Në faqen e jashtme të pilastrit, ndodhet një pllakë guri me mbishkrim në gjuhën greke, e cila mban datën 1770. Nga gjurmët e sotme nuk është e mundur të kuptojmë nëse kjo pjesë ka qenë dy katëshe apo jo. Gjurmët me të vjetra të ndërtimit në vazhdim janë të pa diskutueshme, pasi deri në qoshen perëndimore, një rindërtim dy katësh, i mëvonshëm ka zhdukur mjaftë nga gjurmët e para (Fig.26).

Seksioni “B”

Muratura- Nga dokumentacioni arkivor pranë IKTK-së si dhe ai i shkruar në revistën “Monumente”, thuhet se muri i jashtëm jugor i konakëve ka patur problem të karakterit konstruktiv i cili shfaqte epje për nga jashtë. Më të ndjeshëm këtë problem e kishte bërë humbja e aftësisë mbajtëse të kontrafortëve. Si masë përforcuese u vendosën tiranta metalik në nivelin e dyshemesë, të cilat lidhën murin e dëmtuar me dy muret e brendshme, si dhe u krye pastrimi dhe injektimi me leng gëlqereje i zonës ku muri kishte shpërbërje dhe degradim të llaçit. Kontrafortit ju përforcua tabani me themel butobetoni dhe u vendosën katër unaza metalike përgjatë kontrafortit. Në kontrafortet e rrënuara, të cilat dolën në dritë pas uljes së nivelit të dheut, u kryen punime konsolidimi (muri rrethues midis Sektori “B” dhe “C”).

Nga inspektimi i bërë në terren u konstatua që edhe pas masave të marra, ndërhyrjeve restauruese të kryera në vitet 80, problemet konstruktive të këtij paret mural vazhdojnë të jenë ende. Aktualisht në pjesën ku është realizuar vendosja e tirantit në vitet 80 dhe më konkretisht në murin ku fillon dhoma e parë e konakëve, kontraforti i parë dhe i dytë e kanë humbur plotësisht aftësinë e tyre mbajtëse. Kontraforti i parë (Fig. 27), prej së cilit ka mbetur vetëm gjysma, është plotësisht i shkëputur nga paret mural. Gjatë rrëzimit të tij janë shkëputur edhe gurë të paretit mural duke e lënë në dukje dhe nën efektin e agentëve atmosferik zemren e murit të konakëve. Aktualisht epja nga jashtë e murit të konakëve

mbahet vetëm nga tirantat e vendosura në nivelin e dyshemesë së katit të parë. Gjithashtu edhe kontraforti i dytë (Fig. 28) ka pësuar një çarje nga lartë poshtë deri në lartësinë 1m nga niveli i tokës. Çarja përfundon në një zgavër në murin e kontrafortit nga ku duket qartë brezi i degraduar i drurit që ka realizuar lidhjen e kontrafortit me murin e konakëve (Fig.29). Muri midis këtyre dy kontrafortëve duket që është shumë i degraduar dhe ka pësuar fraktura të shumta. Në ambjentet e brendshme në këtë pjesë të konakëve nuk evidentohen problemet e strukturës, duke qenë se në 2018 janë kryer punime suvatimi dhe stukime nga vetë kisha.



Fig. 27 – Pamje e kontrafortit të parë




Fig. 28 – Pamje e kontrafortit të dytë



Fig. 29 – Pamje e arkitraut të drurit në kontrafortin e dytë

- *Propozohet restaurimi i këtyre dy kontrafortëve:*
 - Të bëhet çmontimi i kontrafortit të rrëzuar, dhe rindërtimi i tij duke e përforcuar bazamentin me murë guri lidhur me llaç (shih grafikën). Gjatë ndërtimit do të realizohet edhe ndërthurja e tij me murin e konakëve.
 - Të restaurohet kontraforti i dytë me tekniken Shqep-qep gjatë së cilës do të zvendësohet edhe brezi lidhës prej druri. Të përforcohet bazamenti i tij me mur guri lidhur me llaç.
- *Pasi të kenë përfunduar punimet restauruese të kontrafortëve të bëhet sistemimi i terrenit midis këtyre dy kontrafortëve dhe të mbillen 2-3 rrënjë selvi në pjesën ku terreni fillon të thyhet duke krijuar kështu një "pilotim" natyral të terrenit.*
- *Propozohet konsolidim i murit të gurit (krahun jugor- perëndimor i konakëve) me teknikën e injektimit (Si tek narteksi i kishës së madhe).*
- *Propozohet ngritja e kontrafortëve të tjerë në murin që lidh Seksionin "B" me atë "C".*

Aktualisht dhomat e katit të parë janë funksionale dhe çdo dhomë ka një WC. Tubacionet e tualeteve janë nxjerrë direkt në faqen e jashtme të konakëve (krahun jug-perëndimor) duke shkarkuar vertikalisht në një kanalizim sipërfaqësor. Gjatë këtyre punimeve janë krijuar kavitete në muraturë të një madhësie të konsiderueshme të cilat janë lënë të hapura. Ekspozimi i vazhdueshëm i këtyre tubacioneve PVC ndaj diellit ka bërë që të degradojnë si material dhe të çahen duke lejuar rrjedhjen e ujit dhe shkarkimin e tyre në sipërfaqe të tokës. Kjo pamje, si vizualisht ashtu edhe nga ana e higjienës nuk është aspak dinjitoze për një objekt monument kulture kaq të rendësishëm siç është ky manastir.

- *Propozohet heqja e këtyre tubacioneve dhe spostimi i tyre nga krahun i brendshëm i këtij muri, dhe nxjerrja jashtë e tyre në nivelin e nëntokës ku çdo njëra do të ketë një pusetë të vogël shkarkimi prej së cilave me anë të tubacioneve nëntokësore do të mblidhen në një pusetë më të madhe dhe do të largohen nga manastiri drejtë gropës septike që ndodhet në perëndim të tij.*
- *Mbyllja e kaviteteve në muraturë me gure dhe llaç.*
- *Pastrimi mekanik i fasadës nga fugatimi i degraduar dhe rifugatimi.*

Gjatë ndërhyrjeve që janë kryer për përshtatjen e katit përdhe në tavernë (punime të lëna përgjysëm), në krahun jugor të konakëve, janë bërë pëforcime me trarë B/A dhe janë vendosur instalimet e reja elektrike një pjesë e së cilave kalojnë në dyshtemenë e ambientit. Tavani i ambientit është dyshtemeja e katit të parë, në të duken të gjitha instalimet hidraulike dhe elektrike të katit të parë. Aktualisht ky ambient është magazinë (Fig. 30 dhe 31).



Fig. 30– Pamje e ambientit të tavernës




Fig. 31– Pamje e ambjentit të tavernës

- Harkada e konakëve

- *Propozohet trajtimi i strukturës drusore të harkadës së konakëve me vaj lini, dhe anti insekticid.*
- *Shtrimi me pllaka guri në ngjyrë grit i harkadës në katin përdhe.*
- *Pastrim i fugave të degraduara në mënyrë mekanike në të gjithë muraturën e shkallëve dhe rifugatim me llaç hidraulik.*
- *Pastrim i fugave të degraduara në mënyrë mekanike në gjithë muraturën e harkadës nga ana e jashtme, në katin përdhe dhe rifugarim me llaç hidraulik.*

Seksioni “C”

Seksioni “C”, ku është pozicionuar edhe hyrja kryesore për në manastir përgjithësisht është në gjendje të mirë duke qenë se ka patur ndërhyrje dhe mirëmbajta të herë pas herëshme.

- *Propozohet qepja e çarjes me injektim mbi portën hyrëse, në pjesën ku bëhet bashkimi i murit të portës me qemerin.*
- *Propozohet restaurimi i oxhakut në katin e parë, dhoma e pritjes.*
- *Trajtimi i dritareve dhe dyerve me vaj lini dhe anti insekticid.*
- *Lyerje e zgarave të hekurit në dritare me bojë të zezë kundra ndryshkut.*

Seksioni “D”

Muratura- Ndarja e parë e katoit komunikon në krahun përfundimor me një dhomë të mbuluar me qemer guri, e cila ka funksionuar në vitet e komunizmit si vend për të sëmuret psikik. Ky amjent ka problem me lagështinë që vjen nga kalldrëmi i oborrit në krahun jugor

të kishës së Shën Thanasit. Këtë fakt e dëshmojnë edhe dy tirantatët prej druri në qemerin e këtij ambjenti që janë plotësisht të kalbur të cilët e kanë humbur funksionin e tyre si dhe arkitrau i hyrjes në krahun lindor të këtij ambjenti (Fig.32).

- *Propozohet shqepja e kalldrëmit ekzistues, zbankimi i dherave dhe pastrami i kreut të qemerit dhe muraturës nga dherat dhe llaci i degraduar. Më pas propozohet të bëhet konsolidimi i qemerit të gurit me llac hidraulik, rimbullimi i qemerit me dherat e hequr, shtresë cakëlli 5 cm, shtresë betoni 10 cm, shtresë hidroizoluese 2 duar, shtresë rrëre natyrore, shtresë kalldrëmi. Në këtë mënyrë do të bëhet e mundur pengimi i penetrimit të ujërave të shiut në këtë ambient dhe në ambientin ngjitur (krahun lindor) shih grafikën.*
- *F.V tirant druri në qemer.*
- *F.V arkitra druri mbi hyrjen që lidh këtë ambient me dhomën e parë të katoit.*




Fig. 32– Pamje e dhomës

Ambjentet e brendshme - Për të hyrë në këtë ambient na u desh të hynim poshtë vendodhjes së dëpos së re prej PVC-je, në ambientet e katoit, në anën veriore të kishës së Shën Thanasit aty ku dhe ndodhen kontrafortët e vendosur në vitet 80, që përforcojnë murin verior të kishës. Këto ambiente duket që kanë probleme me lagështinë që vjen nga oborri para hyrjes së kishës (Fig.33)




Fig. 33– Pamje e ambientit në anën veriore të Kishës së Shën Thanasit, kati perdhe

- *Propozohet disiplinimi i ujërave të shiut që vijnë nga çatia e konakëve në oborrin para hyrjes së kishës së Shën Thanasit duke vendosur ulluk shkarkimi vertikal si dhe lidhjen e tij me sistemin e tubacionit të shkarkimit.*
- *Restaurim-trajtim i strukturës drusore, breza lidhës, pragje dyersh, tavan, kolona, dyer, parvaze etj., me vaj lini dhe anti insekticid.*
- *Heqje suvaje të degraduar dhe risuvatim i ambjenteve dhe lyerje me sherbet gëlqere.*

Muri perimetral i ambjenteve të konakëve nga ana veriore është i përforcuar me kontrafortë të cilët nuk e ruajnë rolin e tyre duke qenë se janë të shkëputur nga paret mural (Fig.34).



Fig. 34– Pamje e kontrafortëve në faqen veriore të konakëve

- *Propozohet mbushje e boshllikut midis kontrafortëve ekzistues dhe murit të konakëve për të rivendur në funksion këto kontrafortë (Shih detajin grafik).*
- *Propozohet pastrimi fasadave nga fugat e degraduara në mënyrë mekanike dhe rifugatimi i tyre me llaç hidraulik.*
- *Trajtimi i brezave lidhës në fasadë, dritareve dhe dyerve me vaj lini dhe anti insekticid.*
- *Lyerje e zgjarave të hekurit në dritare me bojë të zezë kundra ndryshkut.*

Seksioni “E”

Muratura - Muri i konakëve verior, pavarësisht se ka patur shumë ndërhyrje, tamponime, është në gjendje relativisht të mirë përveç pjesës ku ai ruhet në nivelin e katit përdhë. Ky fragment i zbuluar ndaj agentëve atmosferik ka problem me lagështinë në pjesën e kreut të tij

dhe atë fundore, në nivelin e terrenit nga ana e brendshme (terreni nga oborri verior i kishës së madhe) ka një disnivel rreth 1m më lartë sesa tërëni përreth manastirit nga jashtë. Problemet e lagështisë shikohen qartë tek rrënojat e mbetura nga ambientet ndihmëse jashtë murit rrethues të manastirit (Fig.35).

Vargu i karhut verior të konakëve përbëhet nga dhoma të lidhura nga një korridor gjatësor, hyrja e të cilit del në oborrin verior. Ky krah vazhdon deri në drejtim të murit perëndimor të narteksit të kishës ku lidhet me Sektorin “A” të konakëve. Sot një pjesë e tij është rrënojë. Thujtja e plotë ruhet vetëm fasada jugore, ku dallohen dritaret dhe porta me hark e cila lidh oborrin verior me atë që ndodhet para kishës së Shën Thanasit. Faqja veriore, ruhet vetëm në lartësinë e katit përdhe ku ndodhet katoi (Fig. 35-36).



Fig. 35– Pamje e oborrit verior



Fig. 36– Pamje e oborrit verior-porta me hark që lidh oborrin verior me oborrin para kishës së Shën Shanasit

Siç mund të shikohet edhe nga fotot muri është në një gjendje shumë të degraduar duke qenë se është i zbuluar ndaj agjentëve atmosferik. Faktorët atmosferikik kanë ndikuar në

kalbëzimin e të gjithë brazave lidhës të muraturës si dhe humbjen e pjesshëm të tyre. Penetrimi i lagështisë si nga sipër ashtu edhe nëpërmjet kapilartietit ka bërë edhe degradimin dhe humbjen e lidhësit duke rrezikuar seriozisht edhe shembjen e këtij muri. Shkallët që shërbejnë për ngjitjen nga oborri verior për në oborrin para kishës së Shën Thanasit janë të sajura nga vet administruesit e manastirit për të bërë funksional qarkullimin e vizitorëve. Dy oborret në fjalë nuk janë të shtruar me pllaka guri apo me kalldrëm. Sistemi i kullimit të ujërave të çatisë së kishës së madhe (Fig.32), është i dëmtuar dhe i sajuar nga vet administratorët me tubo të materialeve të ndryshme. Ujërat e shiut pasi kalojnë nëpërmjet tubacionit vertical shkarkohen në tokë pa realizuar disiplinimin e tyre në një sistem të mirëfillt drenazhi.

- *Propozohet pastrimi në mënyrë mekanike i gjithë muraturës së këtij ambjenti nga llaçi i degraduar dhe vegjetacioni i ulët me herbicid. Pasi të jëtë bërë pastrimi do të ri fugatohet me llaç.*
- *Konsolidimi i muraturës më 2-3 rrjeshta gurësh (sipas nevojës) me llaç hidraulik.*
- *Zëvendësim i brezave prej druri dhe trajtimi i atyre ekzistues në gjendje të mirë me vaj lini dhe solucion anti insekticid.*
- *Restaurimi i arkitraut të portës lidhëse ndërmjet dy oborreve.*
- *Plotësimi me mur guri i paturave anësore të portës lidhëse ndërmjet dy oborreve.*
- *Ndërtimin e shkallëve prej guri që do të lidhi oborrin verior me atë para hyrjes së kishës së Shën Thanasit.*
- *Pastrim nga bimësia e ulët në të dyja oborret si dhe në mjedisët ndihmëse jashtë murit perimetral të manastirit (Fig.37).*



Fig. 37– Pamje e ambjenteve ndihmëse jashtë murit rrethues të mansatirit fasada veriore
Mjedise të tjera ndihmëse ka patur edhe në anën e jashtëme prej së cilave sot ruhen vetëm gjurmët e tyre (Fig. 37).

Çatitë e gjithë manastirit janë restauruar së fundmi dhe aktualisht janë në gjendje të mirë. (Fig.38).



Fig. 38– Pamje e çative të manastirit

1. Bibliografia:

- Arkiva IKTK
- Pirro Thomo, *Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë, 1998, f. 206-209*
- P. Thomo, G. Stratobërdha, *Restaurimi i monumenteve të Kishës Ortodokse në Shqipëri, Tiranë, 2005*

- Reshat Gega, Arkitektura dhe restaurimet në Manastirin “Fjetja e Shën Mërisë” në Ardenicë, *Monumentet, Nr. 1, 1988, f. 141-176*
- Sokol Çunga “ Përshkrimi i Mitropolisë së Shenjtë të Beratit nga Anthim Aleksudhi si burim historik” , Revista monumentet Nr.59/2020, Faq-140.

TIRANE 2021

Punoi: Ark Ronela Çuku

Ark Arbjona Bala

Ing Zaim Lila

